

URDHËR
Nr. 41, datë 6.2.2026

**PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE DHE CAKTIMIN E DETYRAVE TË
ZËVENDËSMINISTRIT TË MJEDISIT, ZNJ. ELDA XHUMARI**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 22, 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurës Administrative të Republikës së Shqipërisë”; të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të pikës 2, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Mjedisit, zëvendësministres së Mjedisit, znj. Elda Xhumari, për ushtrimin e kompetencave në fushën e mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjes nga ndryshimet klimatike, biodiversitetit, zonave të mbrojtura, gjuetisë, menaxhimit të pyjeve, ekonomisë qarkulluese, menaxhimit të mbetjeve, cilësinë e ajrit, monitorimit mjedisor dhe vlerësimit të ndikimit në mjedis.

2. Në ushtrim të kompetencave të deleguara sipas pikës 1 të këtij urdhri, zëvendësministrja ngarkohet të kryejë detyrat e mëposhtme:

a) Ndjek dhe koordinon proceset që lidhen me zbatimin e programit të qeverisë në fushën e mbrojtjes së mjedisit, menaxhimit të mbetjeve, biodiversitetit, pyjeve, ndryshimeve klimatike dhe ekonomisë qarkulluese, përfshirë strategjitë kombëtare dhe planet e veprimit përkatëse;

b) Kontribuon në hartimin, plotësimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor dhe nënligjor në fushën e mjedisit, duke përfshirë mbetjet, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe vlerësimin strategjik mjedisor (EIA/SEA), zonat e mbrojtura, pyjet, monitorimin mjedisor, ndotjen industriale, cilësinë e ajrit, ekonominë qarkulluese, ndryshimet klimatike – në përputhje me *acquis* të BE-së dhe angazhimet e kapitullit 27;

c) Ndjek procedurat për hartimin e projektakteve ligjore e nënligjore, në përputhje me planin vjetor të projektakteve, të miratuar, si dhe çdo akti tjetër ligjor e nënligjor në fushën e mjedisit;

ç) Monitoron dhe koordinon zbatimin e strategjive dhe programeve kombëtare mjedisore dhe nënshkruan aktet përkatëse, përfshirë:

i. Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Mbetjeve;

ii. dokumentin strategjik dhe të planeve kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike;

d) Siguron të dhëna, analiza dhe raporte periodike mbi politikat kombëtare të mjedisit dhe progresin e tyre drejt përafrimit me *acquis* të BE-së;

dh) Drejton grupe pune për analizimin dhe përmirësimin e programeve dhe projekteve në bashkëpunim me ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë;

e) Drejton punën për nënkapitullin e ndryshimeve klimatike;

ë) Trajton dhe monitoron kthimin e përgjigjeve për kërkesat dhe ankesat e institucioneve publike dhe organizmave të tjerë në fushën e mjedisit;

f) Ndjek dhe nënshkruan aktet e nxjerra në bazë të legjislacionit në fuqi, përfshirë edhe autorizimet që lëshon ministri, në rast mungese të tij, sipas aktit përkatës të delegimit;

g) Përfaqëson Ministrinë në këshilla, komisione, grupe pune dhe procese ndër-institucionale brenda dhe jashtë vendit, sipas delegimit dhe fushës së përgjegjësisë;

gj) Bashkëpunon dhe koordinon me zëvendësministrat e tjerë për çështje ndërsektoriale që lidhen me mjedisin dhe ndryshimet klimatike;

h) Informon periodikisht dhe sipas nevojës Kabinetin e Ministrit për ecurinë e detyrave dhe zbatimin e tyre;

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të lehtësojë dhe mbështesë zëvendësministrin për përmbushjen e detyrave të ngarkuara.

4. Delegimi i kompetencave sipas këtij urdhri përfundon me shfuqizimin e aktit të delegimit, si edhe me pushimin e ekzistencës së organit delegues ose të deleguar.

5. Urdhri i ministrit të Mjedisit nr. 644, datë 12.12.2025, “Për delegimin e kompetencave dhe caktimin e detyrave të zëvendësministrit të Mjedisit, znj. Elda Xhumari”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri zëvendësministri i Mjedisit, znj. Elda Xhumari dhe Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I MJEDISIT
Sofjan Jaupaj